



KUVENDI I SHQIPËRISË

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin

Tiranë më, 6.11.2019

Dokument parlamentar

RAPORT PËR

PROJEKTLIGJIN “PËR ADERIMIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË KOMISIONIN NDËRKOMBËTAR PËR EKSPLORIMIN SHKENCOR NË DETIN MESDHE”

- ***Hyrje***

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin, bazuar në nenet 32 - 38 të Rregullores së Kuvendit, në cilësinë e Komisionit përgjegjës, shqyrtoi projektligjin “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë për eksplorimin shkencor në detin Mesdhe”, në mbledhjen e tij të datës 6 nëntor 2019.

Komisioni caktoi relator për këtë projektligj Zotin Andrea MARTO.

Të pranishëm gjatë shqyrtimit të projektligjit ishin përfaqësues të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit.

- ***Baza kushtetuese e projektligjit***

Projektligji “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë për eksplorimin shkencor në detin Mesdhe” është nismë e Këshillit të Ministrave dhe i paraqitet për shqyrtim Kuvendit mbështetur në nenet 78, 83, pika 1, dhe 121 pika 1 të Kushtetutës.

Miratimi i këtij projektligji kërkon një shumicë të thjeshtë votash, sipas nenit 55, pika 1 e Rregullores së Kuvendit.

- ***Qëllimi dhe përmbajtja e projektligjit***

Qëllimi i projektligjit është aderimi i Republikës së Shqipërisë në Komisionin Ndërkombëtar për Eksplorimin Shkencor në Detin Mesdhe, si dhe kontribuimin e vendit tonë në zbulimin dhe mbrojtjen e Detit Mesdhe dhe deteve që kontribuojnë në këtë det.

Komisioni Ndërkombëtar për Eksplorimin Shkencor në Detin Mesdhe është një organizatë ndërqeveritare me seli në Marok. Komisioni përbëhet nga të deleguarit e Shteteve Nënshkruese që lagen nga Deti Mesdhe dhe nga detet që e përbëjnë këtë det, si dhe nga të deleguarit e qeverive të Shteteve Nënshkruese që nuk lagen nga ky det, por që kryejnë hulumtime, studime dhe punë oqeanologjike në këtë det. Komisioni është i organizuar në 6 Komitete.

Pranimi në Komisionin Ndërkombëtar për Eksplorimin Shkencor në Detin Mesdhe të Shteteve që nuk lagen nga deti Mesdhe bëhet me miratimin e dy të tretave të anëtarëve, ndërsa presidenca e Komisionit i takon njërit prej Shteteve nënshkrues që laget nga deti Mesdhe.

Komisioni Ndërkombëtar për Eksplorimin Shkencor në Detin Mesdhe ka për objekt dhe qëllim që të kontribuojë në zbulimin dhe mbrojtjen e detit Mesdhe dhe deteve që lidhen me këtë det, duke:

- favorizuar punimet hulumtuese në bashkëpunim me institutet kombëtare dhe organizatat ndërkombëtare që kanë qëllime të ngjashme;
- nxitur programet multilaterale të mbikëqyrjes së mjedisit detar;
- lehtësuar shkëmbimet e informacionit dhe botimet veçanërisht në fushën e oqeanografisë, biologjisë ujore, gjeologjisë ujore dhe të biogjeokimisë.

Shtetet nënshkruese, angazhohen për një periudhë pesëvjeçare e cila, me mbarimin e saj, ripërtërihet në heshtje për një periudhë tjetër prej pesë vjetësh. Shtetet nënshkruese mbështesin një rrjet me disa mijëra studiues detarë, të cilët përdorin mjetet më të fundit shkencore për të kuptuar, monitoruar dhe mbrojtur më mirë Detin Mesdhe i cili po ndryshon shpejt dhe po sjell ndikime të mëdha.

Me anëtarësimin në këtë Komision, Republika e Shqipërisë do të përfitojë ndihmë teknike dhe financiare, nëpërmjet projekteve të vogla dhe të mesme, për të mbrojtur dhe për të zhvilluar në mënyrë të qëndrueshme zonën detare të rajonit tonë.

Komisioni integron një spektër të gjerë të disiplinave detare, duke përfshirë proceset gjeo-fizike, kimike dhe biologjike, së bashku me hartat me rezolucion të lartë të fundit të detit.

- ***Vlerësimi i Ligjshmërisë Kushtetuese dhe harmonizimi me legjislacionin në fuqi dhe aktet ndërkombëtare.***

Projektligji është në përputhje me nenet 78, 83, pika 1, dhe 121 pika 1 të Kushtetutës, si dhe me ligjin nr.43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”.

Në aspektin procedural projektligji është paraqitur në përputhje me Rregulloren e Kuvendit.

Në aspektin formal projektligji përbëhet nga 2 nene.

- ***Vlerësimi i përputhshmërisë së projektligjit me Acquis Communautaire***

Ky projektligj nuk përafron ndonjë legjislacion të BE-së.

- ***Efektet financiare të projektligjit***

Angazhimi si anëtar i Komisionit Ndërkombëtar për Eksplorimin Shkencor në Detin Mesdhe sjell si pasojë detyrimin për të derdhur një kontribut vjetor të përcaktuar nga Byroja. Kuota e Shqipërisë kap vlerën prej 25 000 eurosh.

- ***Diskutimi në komision***

Relatori i projektligjit u shpreh që ky aderim është i rëndësishëm pasi Republika e Shqipërisë do të përfitojë ndihmë teknike dhe financiare, nëpërmjet projekteve të vogla dhe të mesme, për të mbrojtur dhe për të zhvilluar në mënyrë të qëndrueshme zonën detare të rajonit tonë.

Përfaqësuesit e Ministrisë shpjeguan elementët kryesor të këtij aderimi si dhe të funksionimit të Komisionit dhe përfitimeve që do ketë vendi nga anëtarësimi në këtë Komision.

Diskutimet në Komision, u përqëndruan kryesisht në efektet që do të ketë Shqipëria nga anëtarësimi në këtë Komitet.

- ***Përfundim***

Në përfundim të diskutimeve, Komisioni vlerësoi projektligjin për krijimin e mundësive për të përfituar dhe kontribuar nga anëtarësimi në këtë Komision.

Komisioni e miratoi projektligjin në parim, nen për nen dhe në tërësi me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm dhe u shpreh dakord për kalimin e këtij projektligji për miratim në seancë plenare.

Andrea MARTO

Niko PELESHI

Relator

Kryetar